



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 01 Maj 2021

Nr: 329

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. NAPOLON ENGJËLL
LASKA, KANDIDAT PËR DEPUTET I SUBJEKTIT ZGJEDHOR NISMA THURJE,
QARKU TIRANË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E
INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të pikës 12 të Kreut V, të Vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 552/40 prot., datë 15.04.2021, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit politik Nisma Thurje, qarku Tiranë,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për



Data: 01 Maj 2021
Nr. 329

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit politik Nisma Thurje, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr.

138/2015

administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", z. Napolon Engjëll Laska, kandidat i listës shumëmemërore të subjektit politik Nisma Thurje, Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër 1251 unik.

- i. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1818 prot., datë 08.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 1817 prot., datë 09.03.2021, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
- ii. Me shkresën nr. 2545/1 prot., datë 09.03.2021, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin e gjendjes gjyqësore me nr. 17 datë 09.03.2021, sipas së cilës rezultoi se, kandidati për deputet z. Napolon Engjëll Laska ka të dhëna në sistem, "Me vendimin nr. 219 datë 22.05.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier e deklaroi fajtor për veprën penale të "Pengim i qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor", parashikuar nga neni 293, 55 i Kodi Penal dhe nenit 406 K.Pr.P e dënonte me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullim i ekzekutimit të dënimit për 6 (gjashtë) muaj me kusht". Rehabilituar në bazë të nenit 69 Kodi Penal.
- iii. Me shkresën nr. 984/1 prot., 1157/1 prot., 1092/1 prot., datë 08.04.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme e Gjendjes Civile, rezultoi se z. Napolon Engjëll Laska nuk ka kryer ndryshime në gjenealitete.
- iv. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 155 datë 17.03.2021, vendosi Miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për deputet, të Partisë Nisma Thurje, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, për zonat zgjedhore, Qarku Berat, Qarku Dibër, Qarku Durrës, Qarku Elbasan, Qarku Fier, Qarku Gjirokastrë, Qarku Korçë, Qarku Kukës, Qarku Lezhë, Qarku Shkodër, Qarku Tiranë dhe Qarku Vlorë.



II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Napolon Engjëll Laska. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Napolon Engjëll Laska, rezulton se kandidati për deputet, i është përgjigjur me “Jo” të gjitha pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit.

Referuar përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me nr. 2545/1 prot., datë 09.03.2021, të administruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr. 1818/1 prot., datë 10.03.2021, duke qenë se referohet një vendim gjyqësor për kandidati për deputet z. Napolon Engjëll Laska, por subjekti vetëdeklarues nuk ka deklaruar asnjë vendim gjyqësor në formularin e vetëdeklarimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreu V, pika 3, shkronja “b” e Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, KQZ me shkresën nr. 2684 prot., datë 25.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Më shkresën nr. 552/40, datë 15.04.2021, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin e rezultatit të verifikimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike” për subjektin vetëdeklarues, z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i Partisë Nisma Thurje, qarku Tiranë.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin vetëdeklarues, z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i Partisë Nisma Thurje, qarku Tiranë”, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme iu është drejtuar institucioneve si më poshtë për verifikim të mëtejshëm:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 3513/1 prot., datë 01.04.2021, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 01.04.2021. Nga ky dokument informohemi se shtetasi Napolon Engjëll Laska, i datëlindjes 17.01.1989, me vendimin nr. 219, datë 25.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor” dhe në bazë të nenit 293, 25, të Kodit Penal dhe 406 të Kodit të



Procedurës Penale, është dënuar me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit për 6 (gjashtë) muaj me kusht.

- ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 1392/1 prot., datë 07.04.2021, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit z. Napolon Laska, sipas Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave konstatohet se subjekti z. Napolon Laska, me atësi Engjëll dhe amësi Violeta, lindur në Fier në datë 17.01.1989, me numër personal I90117021M, figuron i regjistruar banor në zyrën e gjendjes civile, në Njësinë Administrative Mbrostar Ura, Bashkia Fier, konstatohet se nuk ka ndryshime në përbërsit e gjendjes civile.
- iii. Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, rezulton se subjekti z. Napolon Laska:
- ka ato gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit dhe që janë konfirmuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - në datë 22.02.2017, janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për shtetasin Napolon Laska, pasi ka marrë pjesë në një grumbullim të paligjshëm.
 - në sistem, në datë 24.03.2017, figurojnë të dhëna lidhur me referimin e materialeve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal për disa shtetas, përfshirë këtu dhe subjektin Napolon Laska, pasi kanë marrë pjesë në një grumbullim të paligjshëm, duke bllokuar punimet për ndërtimin e implantit të përpunimit të plehrave.
 - nuk figuron si person i dëbuar nga territori i një shteti tjetër apo që të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar në ngarkim të tij;
- iv. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale, me shkresën nr. 6240/2 prot., datë 07.04.2021, na informon se:
- nga të dhënat e grumbulluara në sistemin elektronik, subjekti z. **Napolon Engjëll Laska**, lindur në datë 17.01.1989, nuk figuron i ndaluar /arrestuar nga strukturat e policisë së shtetit.
 - nuk ka të regjistruara gjenealitete të tjera, përveçse ka deklaruar;
 - nga verifikimi i kryer në arkivën elektronike të ZQK Interpol Tirana ka rezultuar se, ky shtetas nuk ka të dhëna për arrestime/ ndalime, apo vendime për masa sigurimi si dhe nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar, nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i një shteti tjetër, apo të jetë në kërkim ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i huaj.



v. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me shkresën nr. 3244/1 prot., datë 02.04.2021, lidhur me subjektin z. Napolon Laska informon se, pas verifikimeve të kryera rezulton se kjo Prokurori:

v-1 ka regjistruar procedimin penal nr. 1626, datë 02.12.2016, për veprën penale të “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga neni 293, 25 të Kodit Penal. Në datë 22.11.2017 është dërguar kërkesa për gjykimin e procedimit penal nr. 1626, datë 02.12.2016 pranë Gjykatës së Shkallës Parë Fier. Në datë 14.06.2018, nga ana e prokurorisë është nxjerrë urdhri i ekzekutimit nr. 628, për vendimin nr. 219, datë 25.05.2018. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin të fashikullit të procedimit penal.

Referuar materialeve të përcjella rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me vendimin e datës 02.12.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. 1626, për veprën penale të “Pengimit të Qarkullimit të mjeteve të transportit”, parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal. Me vendimin “Për njoftimin e akuzës ndaj shtetasit Napolon Laska”, datë 10.11.2017, shtetasi Napolon Laska është marrë i pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 293 i Kodit Penal. Me kërkesën e datës 22.11.2017, prokuroria ka bërë kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq me disa të pandehur, përfshirë këtu dhe shtetasin Napolon Laska.

Me vendimin nr. 62-2018-130 (14), datë 17.01.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka pranuar kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim.

Me vendimin nr. 219, datë 25.05.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, ka vendosur;

- deklarimin fajtor të të pandehurit Napolon Laska, për kryerjen e veprës penale të “ Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor”, dhe në bazë të nenit 293-25 të Kodit Penal dhe dënimit me 4 (katër) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Proçedurës Penale, duke zbritur 1/3 e dënimit e dënon përfundimisht të pandehurin me 3 (muaj) burgim.
- Në bazë të nenit 59 të Kodit Penal e pezullon ekzekutimin e vendimit për dënimit me burgim për një periudhë prej 6 (gjashtë) muajsh, me kusht që i pandehuri të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka nxjerrë urdhrin nr. 628/2018, “Për ekzekutimin e vendimit penal” dhe në datë 25.01.2019. Pas përfundimit nga ana e shtetasit Napolon Laska, të dënimit alternativ ka marrë vendim për deklarimin e kryer të dënimit penal.



Me vendimin nr. 04, datë 15.01.2019, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur:

- Prishjen e vendimit nr. 219, datë 25.05.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Napolon Laska.

v-2 Ka regjistruar kallëzimin penal nr. 515, datë 27.03.2017, për veprën penale të “Organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime e manifestime të paligjshme”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal, i cili është mosfilluar në datë 10.04.2017

Referuar materialeve të përcjella me kthimin e përgjigjes rezulton se, në bazë të materialit të ardhur nga Komisioni i Policisë Fier, ku përmendet emri i shtetasit Napolon Laska, kjo prokurori ka regjistruar kallëzimin penal nr. 525, datë 27.03.2017, për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal. Në përfundim të verifikimeve, bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja “ç”, dhe 291/1, 2, të Kodit të Procedurës Penale, është vendosur mosfillimi i procedimit penal për veprën penale të “Organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime e manifestime të paligjshme”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.

vi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. 1945/1 prot., datë 06.04.2021, pas verifikimeve të kryera, ka vënë në dispozicion kopje të njëzuar me origjinalin të vendimit penal nr. 219, datë 25.05.2018, në ngarkim të shtetasit Napolon Laska. (vendim i sipërcituar në pikën 4.5.1).

vii. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me shkresën nr. 322 prot., datë 06.04.2021, ka përcjellë vendimin nr. 04, datë 15.01.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë”.

- Referuar këtij vendimi rezulton se, pas ankimimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, datë 25.05.2018, vetëm nga i pandehuri Napolon Laska, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur; prishjen e vendimit nr. 219, datë 25.05.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit Napolon Laska.

viii. Nga aktet e dërguara prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 4096/2 prot., datë 15.04.2021 rezulton se Shtetasi Italian Daniele Abbruzzese, ka bërë kallëzim në polici në ngarkim të shtetasit shqiptar Napolon Laska. Policia Gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, pasi ka kryer veprimet e para procedurale si dhe duke i konsideruar të dhënat të tilla që krijojnë dyshimin për ekzistencën e një vepre penale, e ka referuar atë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit për këtë fakt Kriminal të referuar nga policia gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal nr. 8525.2018, për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit penal. (pa emër autori të regjistruar).



Në përfundim të hetimeve nga prokurori i çështjes është dërguar kërkesa për pushimin e këtij procedimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin e formës së prerë me nr. 5116.139 akti, datë 22.01.2020, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit, pushimin e çështjes që i përket procedimit penal nr. 8525, datë rregjistrimit 30.10.2018, regjistruar për veprën penale të “Vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Bashkëlidhur kanë vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. 8525/2018.

- ix. Nga informacioni i përcjellë nga prokuroritë e tjera pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, Gjykatave të Apelit dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, rezulton se ndaj subjektit **Napolon Laska** nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qënë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Prokuroria e Përgjithshme në shkresën e saj referon se, në mungesë të indicieve apo të dhënave që do të justifikonin një verifikim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe pas kryerjes së gjithë verifikimeve të mundshme brenda vendit, i konsideron këto verifikime të plota, bazuar në përcaktimet e nenit 8, pika 1, 2 të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10,11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016.

III.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:

- Subjekti vetëdeklarues z. Napolon Engjëll Laska i është përgjigjur me “Jo” të gjitha pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit.
- Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 552/40, datë 15.04.2021, protokolluar me tonën me nr. 2684/1 prot., datë 16.04.2021, ka njoftuar rezultatet e verifikimit të thelluar sipas së cilës, rezulton e provuar se kandidati për deputet i subjektit politik Nisma Thurje, qarku Tiranë, z. Napon Engjëll Laska është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të “Pengimit të qarkullimit të mjeteve të transportit rrugor” dhe në bazë të nenit 293, 25 të Kodit Penal dhe 406 të Kodit të Procedurës Penale është dënuar me 3 (tre) muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal është pezulluar ekzekutimi i dënimit për 6 muaj me kusht.

- Me vendimin nr. 04, datë 15.01.2019, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 219, datë 25.05.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit z. Napolon Engjëll Laska.
- Gjithashtu nga aktet e dërguara prej Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 4096/2 prot., datë 15.04.2021 rezulton se, Shtetasi Italian Daniele Abbruzzese ka bërë kallëzim në polici në ngarkim të shtetasit shqiptar z. Napolon Engjël Laska. Policia Gjyqësore pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, pasi ka kryer veprimet e para procedurale si dhe duke i konsideruar të dhënat të tilla që krijojnë dyshimin për ekzistencën e një veprë penale, e ka referuar atë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit për këtë fakt kriminal të referuar nga policia gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal nr. 8525.2018, për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit penal. (pa emër autori të regjistruar).
- Në përfundim të hetimeve Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pushimin e çështjes datë regjistrimi 30.10.2018, regjistruar për veprën penale të “Vjedhjes së kryer duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal. Bashkëlidhur është vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. 8525/2018.

Sipas përcaktimeve të nenit 2, pika 1, shkronja “a”, të ligjit të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave për *a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë veprë penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal* dhe shkronja “ç”, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave për *ç) për kryerjen me dashje të një krimi që nuk përfshihet në shkronjat “a” dhe “b”, të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.*

Ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4, të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

1. Për personat që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.

4. Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 552/40 prot., datë 15.04.2021, me lëndë vendim për miratimin e rezultateve të verifikimit të thelluar, të depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, deklaron se, kandidati për deputet z. Napolon Engjëll Laska është deklaruar fajtor për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”, dhe në bazë të nenit 186/1 i Kodit Penal është dënuar **me 3 (tre) muaj burgim** dhe për veprën penale të “Vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 135 i Kodit penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë **ka vendosur pushimin e çështjes**.

Referuar rezultateve përfundimtare të verifikimit të thelluar në lidhje me subjektin deklarues z. Napolon Laska, Prokuroria e Përgjithshme referon si më poshtë vijon:

- Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale nga autoritet gjyqësor shqiptar;
- Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezultoi të ketë qënë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk rezultoi të ketë qënë i siguruar me ndonjë masë shtrënguese të sigurisë personale.

Për sa më sipër, referuar deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe konkluzioneve të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se për subjektin deklarues, z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor Nisma Thurje, qarku Tiranë, nuk ka të dhëna që subjekti përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara

në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pika 12 e Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Nisma Thurje, qarku Tiranë, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit të parashikuar nga ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen, ose ushtrojnë funksione publike”.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Osmanaj _____
B.Kodra _____
M.Koja _____
A.Lamçe _____
Y.Merkaj _____

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021



Data: 01 Maj 2021
Nr. 329

Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin vetëdeklarues z. Napolon Engjëll Laska, kandidat për deputet i subjektit politik Nisma Thurje, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015